

UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI FILOZOFIK  
HISTORI- KOHA E RE



EKSPOZE E TEMËS  
“KRIMET DHE MASAKRAT E REGJIMIT SERB NË  
KOMUNËN E SHTIMES 1998-1999”

Kandidatja: Valdete Ademaj Mentori: Prof. asoc. dr. Muhamet Qerimi

Janar, 2022

Në rrugën e gjatë të lëvizjes për çlirim, bashkim dhe përparim të kombit shqiptar, gjatë shekujve dhe pas Luftës së Dytë Botërore, deri në fillim të shekullit XXI, vend meritore zë veprimtaria e personaliteteve të luftëtarëve të lirisë të rreshtuar në UÇK. Ushtria Çlirimtare e Kosovës, organizatë politiko-ushtarake, e cila udhëhoqi luftën Çlirimtare në Kosovë nga fillimi e deri në mbarim. Ky punim dokumenton tortura, vrasje, masakra, përdhunime, dëbime të dhunshme dhe krimet të tjera lufte të kryera nga forcat qeveritare serbe e jugosllave kundër shqiptarëve të Kosovës .Natyrisht , këto krime nuk u kryhen larg syve të botës. Një prej ngjarjeve që ka tronditur opinionin botëror, janë krimet dhe masakrat forcave serbe ndaj popullit shqiptar në Kosovë në vitin 1998-1999, por edhe më herët. Ajo që ndodhi në vitin 1998-1999 në Kosovë, në të vërtetë është tmerruese, e paimagjinueshme. Njerëzimi kanë nevojë për dëshmi .Lufta e UÇK-së është një histori kombëtare në vete, hapi dhe traso i rrugën e Çlirimit të Kosovës, prandaj pjesëmarrja dhe përbërja e saj organizative ushtarake dhe politike duhet të trajtohet me shumë kujdes të veçantë sepse shënon një epope kombëtare në historinë e popullit shqiptar. Adem Jashari dhe Lufta e Drenicës si dhe e trevave të tjera të Kosovës, gjatë historisë sonë kombëtare në përgjithësi e në veçanti, shënojnë një epope në nxitjen e ndjenjave luftarake të popullit shqiptar për rezistencë të organizuar në krye me UÇK –në. Nga ky shembull heroik u nxitën dhe u edukuan luftëtarë e lirisë në të gjitha zonat operative në tërë territorin e Kosovës. Betejat historike të UÇK-së, të udhëhequra nga Adem Jashari dhe strategë të tjerë ushtarakë, janë shembuj tipikë që tregojnë se si veprohet, si luftohet dhe si mbrohet, nderi e dinjiteti familjar e kombëtar në momente më vendimtare të rrezikimit të popullit e të atdheut nga armiqtë shekullorë.

Në vitin 1997-1999, Kosova kishte përjetuar shumë tortura, vrasje , maltretime , masakrime, dhunime, burgosje edhe Komuna e Shtimes, përjetoj krime ,si Gjenocidi serbë në Reçak tronditi tërë opinionin botërorë dhe zbuloi realitetin e popullsisë shqiptare në Kosovë, se me çfarë po ballafaqohej ajo, më tepër se një shekull nga sundimi kriminal i politikës instaluese serbe. Këto zhvillime ishin një shenjë alarmi për intervenim ndërkombëtar, me ç'rast Serbia u kualifikua si një shkelëse e rëndë dhe e vazhdueshme e marrëveshjeve edhe “të marrëveshjes së armëpushimit dhe kthimit të ushtrisë serbe nëpër kazerma”. Raportet e drejtpërdrejta nga vendi i ngjarjes hoqën të gjitha mëdyshjet. Tani, mashtrimet dhe prapavija politike e Sllobodan Millosheviçit dolën në sipërfaqe. Nuk është çudi që bënë lajka edhe sot, me krimin e kryer në Reçak dhe qindra masakrave tjera anë e mbanë Kosovës. Në mbrojtje të popullsisë civile shqiptare, e cila masakrohej pamëshirshëm dhe dëbohej dhunshëm nga Kosova, kështu doli në ndihmë NATO-ja, duke bombarduar për 78 ditë rresht Jugosllavinë. Ky vendim erdhi nga ana e NATO-së, menjëherë pas refuzimit të pales serbe për nënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujës. Tema “Krimet dhe masakrat e regjimit serb në komunën e Shtimes gjatë viteve 1998-1999” ka rëndësi të madhe sepse jep një pasqyrim, një përmbledhje se çfarë kishte ndodhur në Shtime dhe fshatra për rrethe. Se si ishte zhvilluar beteja, luftërat, si ishte bërë shpërngulja e popullit në Shqipëri e Maqedoni si ishte bërë dhuna krimi masakrimi tortura e tjera . Andaj qëllimi i kësaj teme është të ndriçojë se çfarë kishte ndodhur në komunën e Shtimes vrasjet maltretime, masakra, përdhunimet.Tema është e ndarë 3 kapituj; Në Kapitullin e parë kam trajtuar, Krijimi i institucioneve paralele dhe jetësimi i tyre në Komunën e Shtimes, Organizimi i procesit edukativo-arsimor në shtëpitë shkolla në komunën e Shtimes, Dhuna dhe terrori i shtetëror Serb në Komunën e Shtimes ndaj popullsisë civile shqiptare në periudhën 1990-1997. Në Kapitullin e dytë kam trajtuar zhvillimin e luftës në Komunën e Shtimes 1998-1999 Zona Operative e Noredimes shtrirja e saj në Kumunën e Shtimes. Betejat kryesore ndërmjet UÇK-së dhe ushtarake dhe policore

serbe 1998-199. Krimet serbe në Komunën e Shtimes gjatë viteve 1998-1999 të luftës në Kosovë. Masakra e Reçakut. Dëbimi me dhunë nga forcat serbe i popullsisë. Fillimisht tërë Kosova përfaqësonte një zone ushtarake operative të UÇK –së, e cila ndahej në shtatë nënzona operative: Nēnzona e Drenicēs, e Pashtrikut, Dukagjinit, e shalēs, e Llapit, e Noredimes dhe e Karadakut.<sup>1</sup> Nēnzona Operative e Noredimes, fillimisht shtrihej nga fshatrat e Drenicēs: Shalē Fushticē e deri në Gllloboçicē të Kaçanikut. Mē vonē shtrihet nga Gryka e Carralevēs e deri në Gllloboçicē. Kjo zone pērfshinte territorin e këtyre komunave: Lipjanit, Shtimes, Ferizajit, Kaçanikut dhe Shtērpcēs shqiptare në Komunën e Shtimes dhe depērtimi i tyre në Shqipēri, Maqedoni etj. Nē Kapitullin e tretē kam trajtua Zhvillimi i punimeve të Konferencēs së Rambjesē. Ndērhyrja ajrore e trupave të NATOS –sē ndēr caqete ushtrisë dhe policisë në territorin e Komunēs së Shtimes. Çlirimi Kosovēs, respektivisht i komunēs e Shtimēs në qershor 1999. Kthimi i refugjatēve shqiptarē në komunën e Shtimes dhe fillimi i rindērtimit të vendbanimeve të shkatērruar gjatē luftēs.